



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 4494/ Prot.

Tiranë, 16.09 2024

URDHËR

Nr. 441, Datë 16.09 2024

“PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT TË SISTEMIT TË BURGJEVE
2024-2030 ”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2 dhe nenit 16, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, përcjellë me shkresë nr. 13783 prot., datë 29.08.2024,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të zhvillimit të sistemit të burgjeve 2024-2030, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Planifikimi buxhetor sipas afateve të aktiviteteve të parashikuara.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për ngritjen e një grupi pune, për zbatimin e këtij dokumenti strategjik dhe caktimin e një punonjësi si pikë kontakti, për monitorimin dhe raportimin periodik.
4. Ngarkohet Sektori i Arkiv Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Ulsi Manja



PLAN I ZHVILLIMIT TË SISTEMIT TË BURGJEVE

2024-2030

Hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë

Hyrje

Zhvillimi i sistemit të ekzekutimeve të vendimeve penale me burgim përfaqëson një element të rëndësishëm të reformës tërësore penale në Shqipëri, e cila është në të njëjtën kohë prioritet për Ministrinë e Drejtësisë (MD) dhe për Qeverinë Shqiptare në përgjithësi. Parimi i një procesi të rregullt gjyqësor, nuk mund të kuptohet i shkëputur nga procesi i zbatimit të vendimeve penale, si pjesë e rëndësishme e gjithë zinxhirit të sistemit të drejtësisë penale. Për këtë arsye, ky sistem është objekt i monitorimit të vazhdueshëm nga institucionet e pavarura vendore, Europiane dhe të Kombeve të Bashkuara dhe padyshim i Qeverisë Shqiptare.

Sistemi i zbatimit të vendimeve penale me burgim, për një periudhë 30 vjeçare ka pësuar ndryshime në zhvillimet sasiore dhe pëmbajtjen e tij, duke ju përshtatur ndryshimeve politike sociale dhe ekonomike që kanë ndodhur në vendin tonë përgjatë kësaj periudhe. Ndryshimet kryesore evidentohen në filozofinë humanitetit të trajtimit të të burgosurve, e cila është mbështetur në;

- një kornizë ligjore të përafërt me standartet ndërkombëtare,
- në motivimin, trajtimin e stafit dhe krijimin e një kulture institucionale të bazuar në ligjshmëri dhe standartet europiane
- në investime të rëndësishme në ndërtimin e godinave të përshtatëshme dhe me kushte sigurie optimale.

Për gjatë kësaj periudhe evidentohen disa momente të rëndësishme, si;

- Kalimi i sistemit të ekzekutimeve të vendimeve penale (dënimet me burgim) nën administrimin dhe përgjegjësinë e Ministrisë së Drejtësisë në vitin 1994
- Kalimi i paraburgimit nën administrimin dhe përgjegjësinë e Ministrisë së Drejtësisë në vitin 2007
- Themelimi i shërbimit të Provës në vitin 2009, gjë që ka sjellë një reduktim të numrit të të dënuarve me burgim dhe menaxhimin e mbipopullimit.
- Reforma në sistemit të drejtësisë, e cila ka përfshirë edhe reformimin e sistemit të burgjeve, në drejtim të infrastrukturës ligjore, kushteve të trajtimit, trajnimit të stafit etj, 2016- e ne vazhdim
- Miratimi i akteve të reja ligjore në vitin 2020.
- Përmirësime të vazhdueshme në trajtimin ekonomik dhe financiar të stafit
- Aplikimi i regjimit të posaçëm në sigurinë e lartë (Regjimi 41 Bis)
- Aplikimi i hartës së re gjyqësore në vitin 2023

Zhvillimi i sistemit të burgjeve është mbështetur nga disa projekte të rëndësishme të financuara nga KE dhe BE, si:

- Masterplan i vitit 2004, i mbështetur me fonde të BE dhe i hartuar nga ekspert të Ministrisë së Drejtësisë së Austrisë. Ky projekt ka parashikuar ngritjen e institucioneve të reja penitenciare, me fondet e BE, si dhe kuadrin ligjor për kalimin e paraburgimit në administrim të Ministrisë së Drejtësisë. Bazuar në Masterplanin e vitit 2004, për gjatë viteve 2007 deri në vitin 2018, janë ndërtuar këto IEVP, si qendra paraburgimi dhe burgje: Korçë, Fushë-Krujë, Durrës, Kavajë, Vlorë, Vlorë, Berat, Fier, Shkodër.
- Në Masterplan ishin parashikuar të ndërtohen burgje dhe paraburgime në 12 prefektura, duke përfshirë: Gjirokastrë, Dibër, Kukës të cilat nuk janë zbatuar.
- Drejtimi human i burgjeve, mbështetur financiarisht nga Komisioni Europian, në kuadër të programeve CARDS 2004, i realizuar në vitet 2007-2009, i fokusuar kryesisht në rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore
- Në projektin e Binjakëzimit 2016-2017 të mbështetur nga BE dhe zbatuar nga ekspertë nga Shërbimi i Burgjeve UK (NOMS). Masterplan i zhvillimit të burgjeve të Shqipërisë.
Nga ekspertët e shërbimit të burgjeve të UK, është hartuar dokumenti “Raport për konfigurim” të sistemit të burgjeve të Shqipërisë dhe bazuar në vlerësimin e kushteve të ndërtesave të burgjeve, është rekomanduar mbyllja e burgjeve Tropojë, Kukës, Sarandë, për mungesë të kushteve të trajtimit dhe kostos së lartë, për shkak të kapaciteteve të ulta akomoduese që kanë. Njëkohësisht është rekomanduar rikonstruktimi i disa burgjeve dhe gradualisht mbyllja e burgjeve, tip kampesh të regjimit komunist, si Lushnja.
- Plani i Veprimit 2019-2022 i hartuar nga ekspertë të KE dhe DPB, me mbështetjen e ambasadës së UK në Tiranë. Ky plan veprimi parashikon realizimin e 8 objektivave, të cilët kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve të stafit, aplikimin e programeve të rehabilituese, mbrojtjen e të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor, forcimin e sigurisë, parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër korrupsionit.
- Projekti “Mbrojtja dhe forcimi i të drejtave të burgosurve”, mbështetje horizontale për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, i financuar dhe zbatuar nga KE, me focus rritjen e kapaciteteve profesionale, rehabilitimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, i zbatuar në dy faza.
- Mund të themi se me mbështetjen e partnerëve dhe të Qeverisë është formësuar një system penitenciar, që ngjason me praktikën e mira europiane, i bazuar në parimet e respektimit të të drejtave themelore dhe të dinitetit njerëzor që kontribon në mbrojtjen e sigurisë publike nëpërmjet parandalimit individual dhe të përgjithshëm të rishkeljes.
- Sistemi penitenciar shqiptar duhet të zhvillohet më tej, duke pasur si qëllim kryesor rehabilitimin dhe përgatitjen e të burgosurve për jetën pas burgut dhe për ta bërë këtë gjë sa më

mirë në mënyrë që të burgosurit e liruar nga burgu të mos kryejnë vepra të tjera penale, duke marrë parasysh praktikat më të mira evropiane dhe rekomandimet e KiE-s. Megjithatë, duke qenë se këto praktika ndryshojnë vazhdimisht, është shumë e rëndësishme që strategjitë për burgjet dhe dokumente të tjera puna të përditësohen periodikisht, duke marrë gjithmonë parasysh lidhjen midis rregullave të burgjeve dhe instrumenteve të tjera relevante, si dhe standardet dhe rekomandimet në fushën penale.

- Ky projekt synon ti jap një shtysë të re zhvillimit të sistemit të ekzekutimit të vendimeve penale, në këndvështrimin e Rregullave Europiane të Burgjeve duke u përqëndruar kryesisht në këto objektiva:

1. *Forcimi i kapaciteteve organizative dhe funksionale të sistemit zbatimit të vendimeve penale*
2. *Krijimi i një ambjenti të sigurtë dhe promovues*
3. *Ngritja e një ekipi të qëndrueshëm, me integritet, të motivuar dhe profesional*
4. *Forcimi i procesit të rehabilitimit dhe ri-integrimit të të burgosurve*

MISIONI DHE VLERAT:

Misioni:

- Një shërbim profesional në burgje që ofron qëndrim të sigurt dhe njerëzor që garanton mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të personave të privuar nga liria dhe që u jep atyre mundësi rehabilitimi për komunitete më të sigurta.

Vizioni:

- Sistem penitenciar profesional, Shqipëri më e sigurt.

Vlerat:

- ✓ **PUNË NË EKIPI:** Ne arrijmë më shumë duke punuar së bashku.
- ✓ **INTEGRITET:** Ne duhet të kemi gjithmonë guxim për të bërë gjënë e duhur dhe të denjë edhe kur askush tjetër nuk po na shikon
- ✓ **POTENCIAL:** Të gjithë kanë potencial për të qenë një person më i mirë dhe ne kërkojmë në mënyrë aktive që personeli dhe ata që janë në nën kujdesin tonë ta arrijn këtë.
- ✓ **SIGURIA:** Ne kontribuojmë në mënyrë aktive për të krijuar një mjedis në të cilin stafi dhe ata që janë në kujdestarinë tonë ndihen emocionalisht dhe fizikisht të sigurt dhe në fund të fundit, kontribuojnë për një komunitet më të sigurt.
- ✓ **MBËSHTETJE:** Ne kërkojmë mbështetje dhe njëkohësisht ofrojmë mbështetje për stafin dhe rehabilitimi i atyre që janë në paraburgim

LEGJISLACIONI EKZISTUES

- Ligji nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar;
- Ligji Nr.81/2020 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;
- Ligji Nr.80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”;
- Ligji Nr. 78/2020 “Për shërbimin e provës”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 209, datë 06.04.2022 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”;
- Kodi i Etikës për Policinë e Burgjeve;
- Ligji për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve;
- Ligji për Shëndetin Mendor, Ministrinë e Mbrojtjes Sociale dhe Shëndetësinë;
- Ligji për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë;
- Ligji për Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit;
- Ligji për Parandalimin dhe Luftën ndaj Krimit të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera përmes Masave Parandaluese kundër Aseteve.

- SITUATA AKTUALE E SISTEMIT TË BURGJEVE

- a. Harta e sistemit të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim, pasaporta e çdo IEVP lidhur me pozicionin, themelimin, kapacitetin, kushtet fizike higjieno sanitare dhe të sigurisë numri i punonjësve, niveli i vlerësimit të standarteve.
- b. Të dhëna statistikore mbi numrin e të burgosurve në vite, kategoritë e ndryshme, trendi i zhvillimit.
- c. Situata e shërbimit të provës, drejtoritë vendore, të dhëna statistikore të stafit dhe të shkelësve nën monitorim
- d. Të dhëna për burimet njerëzore të sistemit të burgjeve, rekrutimi, trajnimi, dinamika, qëndrueshmëria, mosha, jeta mesatare e punonjësve të sigurisë, organigrama e fundit

Struktura organizative aktuale e Sistemit të Burgjeve në Shqipëri

- Numri i përgjithshëm i personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB) në Shqipëri është 4254 nga të cilët 3464 janë personel me uniformë dhe 1060 janë civilë.
- Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, mbi bazën e kategorisë së subjekteve ndaj të cilave ekzekutohen vendimet penale, ndahen në:
 - a) institucione për të dënuarit e rritur;
 - b) institucione për të dënuarit e mitur;
 - c) institucione për gratë;
 - ç) institucione të paraburgimit;
 - d) institucione të kujdesit shëndetësor për të burgosurit;

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ose seksione brenda tyre, mbi bazën e sigurisë, kategorizohen si më poshtë:

- a) institucione të sigurisë së lartë;
- b) institucione të sigurisë së zakonshme;
- c) institucione të sigurisë së ulët;
- ç) institucione të hapura.

- Sistemi i burgjeve në Shqipëri përbëhet nga 20 qendra burgimi, nga të cilat: 1 institucion për gra autore të veprave penale, 1 institucion për të miturit, 1 institucion i posaçëm që trajton personat me urdhër gjykatë "mjekim i detyruar", 1 spital për trajtimin mjekësor të të burgosurve dhe 16 institucione janë për personat e dënuar me burgim dhe të paraburgosurit.


Numri i përgjithshëm i popullatës në burgje është 5 543, nga të cilët 2824 janë të paraburgosur, ndërsa pjesa tjetër janë si vijon:

- 78 gra, nga të cilat 33 të dënuara dhe 45 në paraburgim;
- 21 të mitur (3 të dënuar dhe 18 në paraburgim);
- 476 në siguri të lartë;
- 2209 në siguri të zakonshme
- 446 shtetas nën masa mjekësore dhe mjekimi të detyruar mjekësor (416 meshkuj, 30 gra)

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Nr.te burgosur	4583	4497	4562	5473	5803	6271	6123	5668	5679	5412	4999	5124	5411	5543
Nr. Staf	3822	3822	3809	3809	3766	4156	4156	4156	4497	4497	4497	4524	4524	4524

Institucioni	2021			2023		
	Civil	Uniforme	Totali	Civil	Uniforme	Totali
Drejtoria e Përgjithshme	69	159	228	130	193	323
Jordan Misja	32	285	317	41	294	335
Mine Peza	24	85	109	27	86	113
Durresi	31	150	181	36	151	187
Vaqarri	22	76	98	0	0	0
Kruja	34	78	112	0	0	0
Rrogozhina	29	136	165	30	137	167
Burreli	24	121	145	27	122	149
Tepelene	21	78	99	24	80	104
Lushnja	24	102	126	26	103	129
Peqini	34	325	359	38	324	362
Lezha	32	209	241	62	202	264
Fushe Kruja	33	221	254	36	222	258
Korça	32	232	264	35	233	268
Kavaja	24	47	71	25	48	73
Fieri	41	336	377	43	335	378
Shkoder	39	327	366	42	326	368
Berat	25	111	136	26	112	138
Vlora	25	109	134	26	111	137
Ali Demi	24	73	97	27	73	100
QSB	287	83	370	290	90	380
Kukes	9	41	50	11	41	52
Tropoja	9	32	41	0	0	0
Saranda	10	41	51	0	0	0
Elbasani	24	109	133	25	110	135
Pojskë	0	0	0	33	71	104
SHUMA	958	3566	4524	1060	3464	4524

STRUKTURA E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVER



- **Numri i të burgosurve nga viti 1990 dhe norma e kriminalitetit për 100.000 banor**

Viti	Numri i të burgosurve	Te burgosur për 100.000
1990	3000	92
1995	3177	97
1998	2922	87
2001	3053	99
2003	3778	121
2005	4356	139
2007	4554	144
2009	4667	146
2011	4779	167
2013	5021	179
2015	5934	205
2017	5418	189
2019	5045	177
2020	4713	
2021	4811	
2022	5440	181
2023	5543	183

- **Numri i të paraburgosurve nga viti 2001 dhe norma e kriminalitetit për 100.000 banor**

Viti	Numri i të paraburgosurve	Perqindja e popullsisë së të paraburgosurve	Të paraburgosur për 100.000 banor
2001	1458	47.8%	47
2005	1727	39.6%	55
2010	1880	39.6%	59
2015	3039	51.2%	105
2022	2868	57%	102
2023	2824	60%	103

- **Pasaporta e burgjeve**

(merren te dhena nga sektori investimeve)

Duke vlerësuar zhvillimet e deritanishme të sistemit të zbatimit të vendimeve penale,

a. Kushtet e sigurisë dhe të trajtimit

- lidhur me zbatimin e hartës së re gjyqësore,
- koston e lartë në mbajtjen e disa burgjeve me kapacitet mbajtës shumë të ulët si Tropojë, Sarandë, Kukës, Tepelenë dhe kushtet e 1

- Kushtet e papërshtatëshme të disa IEVP, si Lushnjë, Burrel, Krujë¹, Rrogozhinë Mine Peza, Ali Demi, Godina A e IEVP Jordan Misja, në drejtim të sigurisë, rehabilitimit dhe kushteve të trajtimit (higjieno sanitare, akomoduese etj)
- Rekomandimet e institucioneve të pavarura si CPT dhe AP për përmirësimin e kushteve të trajtimit.
- Pozicionin e papërshtatshëm të disa burgjeve, për shkak të zhvillimit urban (si psh Jordan Misja, Mine Peza), të cilat jo vetëm që kanë një teritor të kufizuar brenda perimetrit të sigurisë, por ka rrezik për ekspozimin e të burgosurve.
- Të gjitha burgjet e ndërtuara gjatë regjimit komunist dhe më parë, kanë mungesa të hapsirave të mjaftueshme për punësim, ëorkshop kualifikimi, ambiente rehabilituese etj, përveç që disa prej tyre si IEVP Burreli nuk disponojnë as tualete brenda qelive duke vështirësuar garantimin e sigurisë.
- Mungesën e një qendre trajnimi të kompletuar me ambiente akomoduese, hoteleri, klasa të mjaftueshme, palestër, poligon qitje, ambiente për zhvillim praktike etj
- Mangësi në akomodimin e stafit të DPB, si dhe mungesën e ambienteve për magazinimin e produkteve
- Përmirësimin e transportit të të burgosurve
- Përmirësimin e sistemit të kontrollit, monitorimit dhe garantimit të sigurisë

b. Ngritjen e një stafi të qëndrueshëm, profesional, të motivuar

- Përshtatjen e strukturës organike sipas nevojave të shërbimit të sigurisë, trajtimit, menaxhimit dhe kordinimit
- Përmirësimin e kushteve të trajtimit të stafit me uniformë, lidhur me pagën, trajtimin me ushqim, transportin, uniformën
- Zhvillimin e karrierës dhe promovimin e stafit
- Përmirësimi i procedurave të përzgjedhjes, veçanërisht në nivelin e mesëm të sigurisë, duke bashkëpunuar me struktura të tjera me uniformë.
- Ngritjen e Akademisë së Trajnimit në nivel bashkëkohor, me programe të kredituara.

c. Punësimin e të burgosurve dhe aplikimin e programeve rehabilituese, me qëllim uljen e normës së recidivizmit dhe aftësimin e tyre për jetën

¹ Kruja është mbyllur për shkak të kushteve të papërshtatëshme

- Zbatimin e VKM Nr.602, tetor 2021 për punësimin e të dënuarve brenda IEVP dhe nga OE në masën 30%
- Përfshirja e të burgosurve në aktivitete rehabilituese (arsimore edukative, trajnuese, sportive etj) në masën mbi 24 orë në javë për çdo të burgosur
- Aplikimi i programeve të ndërhyrjes për personat përdorues dhe me novoja kriminogjene

ANALIZË E PIKAVE TË FORTA DHE TË DOBËTA TË SISTEMIT EKZISTUES

Pikat e forta :

- Kuadri ekzistues ligjor sipas të cilit punon sistemi i burgjeve në Shqipëri është gjithëpërfshirës dhe i avancuar. Po kështu, ekzistojnë strategji kombëtare të përshtatshme, duke përfshirë këtu edhe planin e veprimit për vitin 2019-2022, i cili është zbatuar. Kuadri ligjor mbulon gjithashtu edhe inspektimet e burgjeve. Po njësoj, kuadri ekzistues ligjor për kujdesin e përgjithshëm shëndetësor dhe atë mendor është i zbatueshëm si për të burgosurit me probleme të përgjithshme ashtu edhe për ata me probleme të shëndetit mendor;
- Ka një angazhim të qartë nga Ministria e Drejtësisë për reformën e vazhdueshme të burgjeve, duke përfshirë këtu, mbështetjen e Shoqërisë Civile si dhe të Organizatave Ndërkombëtare. Në procesin e reformës së sistemit të burgjeve mbështetja nga aktorë të rëndësishëm siç është KE, Ambasada Amerikane, Ambasada Britanike, është e dukshme dhe shumë e rëndësishme.
- Është miratuar një strukturë e re e DPB dhe IEVP-ve që mbulon më së miri nevojat për shërbime njerëzore të kualifikuara.
- Janë bërë hapa të rëndësishëm lidhur me pajisjen e sistemit me mjete transporti, që ka përmirësuar ndjeshëm transportin dhe shoqërimin e të burgosurve dhe stafit.
- Është zhvilluar si asnjëherë më parë digjitalizimi i sistemit të përpunimit të të dhënave dhe menaxhimit të të burgosurve
- Është krijuar gjithashtu një strukturë si edhe një qasje transparente ndaj palëve të interesuara të cilat janë marrë në konsideratë për të gjitha çështjet e reformës së burgjeve;
- Nga projektet e mëparshme ekzistojnë standarde të mirëfillta ndërkombëtare, të cilat ofrojnë një bazë të fortë për kërkesat e ardhshme në lidhje me çështjet e reformës së

burgjeve. Për shembull, me rëndësi të veçantë është arritja në zhvillimin e kurrikulave të trajnimit, duke përfshirë këtu edhe një strategji trajnimi;

- Është bërë një analizë e nevojave si edhe një vlerësim i riskut sa i përket trajnimit, me të gjithë personelin e DPB (policor dhe civil), ku u konstatua se sa u përket trajnimeve, ka një përvojë të gjatë të punonjësve të burgjeve dhe niveli i motivimit është gjithashtu në një shkallë të lartë; dy cilësi këto, të cilat nëse kombinohen siç duhet me kurrikulën dhe strategjinë e trajnimit, mund të japin rezultate pozitive;
- Ekziston një aftësi institucionale e personelit të burgjeve lidhur me inspektimet, duke përfshirë këtu partneritetet ekzistuese për inspektimin / monitorimin e burgjeve me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve është ngritur drejtoria e inspektimit me staf 1+5.
- Është miratuar Udhëzimi Nr.1, datë 17.03.2023, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, për diagnostikimin dhe mjekimin e të pacientëve të burgosur pranë QSNT dhe spitaleve rajonale. Një tjetër marrëveshje me shkrim është ajo me Ministrinë e Arsimit për kurset e specializimit brenda burgjeve, për studentët e fakultetit. Studentëve u ofrohen bursa dhe u paguhet 80% e pagës së një mjeku. Ata duhet gjithashtu të nënshkruajnë një kontratë ku kërkohet që të punojnë edhe për një periudhë prej të paktën tre vitesh pas specializimit;
- Ekziston një organ anti-korrupsion si edhe një Task Force institucionale e brendshme. Po ashtu, ekziston një prokurim i centralizuar elektronik. Në vijim të kësaj, ka një Strategji Kombëtare Anti-Korrupsion 2018-2020, si dhe një Plan Veprimi me theks të veçantë tek Anti-korrupsioni;
- Gjetjet dhe rekomandimet e KLSH janë pranuar, gjë e cila mund të lehtësojë luftën kundër korrupsionit në burgje;
- Bazuar në Aktin për lirinë e informacionit, ekziston një koordinator informacioni si dhe një seksion monitorimi brenda Ministrisë së Drejtësisë (gjithsesi, kjo mbetet për t'u zbatuar);
- Ekzistojnë Agjencia e Deklarimit të Pasurive dhe Drejtoria e Pastrimit të Parave të cilat janë të pavarura;
- Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm të DPB kryen inspektime të rregullta, përfshirë edhe zbulimin e korrupsionit;

- Ekziston një komision brenda DPB që merret dhe shqyrton të gjitha kërkesat nga të burgosurit. Po kështu, ka mjete informative të dukshme se si të burgosurit mund të parashtrijnë ankesat dhe kujt mund ti drejtohen për këtë, në të gjitha shkallët. Të burgosurit gjithashtu mund të bëjnë falas thirrje telefonike të pakufizuara në institucionin e Avokatit të Popullit dhe të kenë akses në zyrën e prokurorit nëse u lind nevoja. Po kështu, oficerët ligjorë janë në dispozicion për të gjithë të burgosurit sipas kërkesës. Në fuqi është edhe një sistem ankesash me 3 nivele;
- Sa i përket Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE), është në fuqi një Strategji Kombëtare dhe Plan Veprimi për zbatimin e saj (NSCVE). Po kështu është në fuqi një Strategji e përgjithshme Komunikimi për rastet e profilit të lartë të kësaj natyre. Për më tepër, ekziston edhe një kuadër ligjor për mbrojtjen e të dhënave dhe mosdiskriminimin;
- Janë kryer programe rehabilitimi mbi Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) dhe personeli i burgjeve është trajnuar në këtë fushë, ku një numër i vogël i tyre janë të aftë të marrin certifikatat përkatëse të sigurisë;
- Ka marrëveshje me komunitetet fetare mbi Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE).

Pikat e dobëta:

- Ka një rritje të shpejtë të numrit të të paraburgosurve, që ka impaktuar në vështirësi të konsiderueshme të akomodimit dhe trajtimit të tyre.
- Megjithë zhvillimet në vite, sistemi i burgjeve të Shqipërisë, akoma vazhdon të mbështetet në një infrastrukturë të dobët të godinave të vjetra që i përkasin regjimit të paraluftës së dytë dhe të komunizmit, të cilët nuk ofrojnë mjaftueshëm kushte për sigurinë, trajtimin dhe rehabilitimin e të burgosurve.
- Burgjet e Shqipërisë nuk ofrojnë mundësi punësimi për të burgosurit, përveç disa shërbimeve të brendshme.
- Ka mungesë personeli në tërësi, si edhe një çekuilibër mes personelit policor dhe atij civil, përfshirë këtu edhe mungesën e orientimit në karrierë dhe mundësive të duhura institucionale.

- Ka një dinamikë të lartë të burimeve njerëzore, hyrje dalje dhe lirime. Nuk ka eksperiencë pozitive lidhur me drejtimin e IEVP-ve në aspektin e procedurave të pranimit dhe zhvillimit të karrierës.
- Sistemi i burgjeve vuan mungesën e fondeve, e cila pasqyrohet veçanërisht në teknologjinë e vjetruar, në ndërtesa, infrastrukturë (përfshirë këtu edhe ambientet e posaçme për të burgosurit me probleme të shëndetit mendor) dhe logjistikë. Mungon një qendër trajnimesh apo edhe ndonjë infrastrukturë e përshtatshme për të ndihmuar në zhvillimin e tyre. Po kështu, institucioni nuk ka një bazë të dhënash kompjuterike, por vetëm regjistra të plotësuar manualisht.

MUNDËSITË

- Ka një vullnet politik të strukturave të sotshme politike, në mënyrë të veçantë Ministrisë së Drejtësisë, që të vazhdohet me reformën gjyqësore në përgjithësi dhe atë të burgjeve në veçanti, duke përfshirë inspektimet në burgje.
- Zhvillimi në karrierë mund të rezultojnë shumë pozitive për shërbimin dhe rritjen e kapaciteteve të tij;
- Është miratuar një marrveshje me Mbretërinë e Bashkuar lidhur me transferimet dhe mbështetje të sistemit të burgjeve të Shqipërisë.
- Ekziston një mbështetje dhe një partneritet i fortë nga organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare, e po ashtu ka aktivitete të vazhdueshme të projekteve; pjesëmarrja në shkëmbimin e përvojave në aspektin ndërkombëtar ka qenë në një interval më të shpeshtë. Për shembull, është zhvilluar strategjia për parandalimin e vetëvrasjeve, është zhvilluar gjithashtu koncepti i Sigurisë Dinamike si edhe kurrikulat e trajnimeve të cilat u përmirësuan bazuar në ndihmën e ofruar nga Instrumenti Horizontal i KiE-s/BE-së. Për të siguruar qëndrueshmëri të punës së mëparshme, këto duhet të zbatohen. Për më tepër, duhet të shfrytëzohen raportet e monitorimit nga organizatat ndërkombëtare për çështjet që lidhen me trajnimin, përfshirë zbatimin e praktikave më të mira ekzistuese në vendet e tjera lidhur me inspektimet e burgjeve;
- Profesionalizmi brenda DPB, bëhet i dukshëm kur personeli i burgut emërohet në pozita vepruese dhe është në gjendje të kryejë detyrat pa probleme. Në përgjithësi është e dukshme aftësia e personelit si edhe e shërbimit në përgjithësi, për tu përshtatur me zhvillimet e reja dhe ndryshimet.

- Implementimi i partneriteteve publike-privat në lidhje me ndërtimin e burgjeve mund të zgjidhë problemet me infrastrukturën dhe logjistikën;
- Zgjatja në tre muaj e trajnimit bazë të personelit të burgjeve dhe profilizimi i tyre në trajnimet e specializuara;
- Trajnimet mund të shërbejnë si nxitës për të luftuar korrupsionin në burgje apo për të identifikuar të dënuarit e përkushtuar duke iu dhënë atyre certifikata vlerësimi.
- Ka një plan inspektimi vjetor për institucionet në varësi, së shpejti edhe një legjislacion të ri për inspektimet në burgje.
- Kodi i sjelljes dhe rregullorja e rekrutimit mund të kontrollohen në lidhje me respektimin e përpjekjeve anti-korrupsion; në kodin e sjelljes duhet të përfshihet edhe siguria e paprekshmërisë.
- Vlerësimi periodik i gjithë personelit të burgjeve si edhe qarkullimi i tij, ndikojnë pozitivisht në parandalimin e korrupsionit në DPB.
- Ministria e Drejtësisë duhet të parashikojë emërimin e një punonjësi përgjegjës për çështjet e integritetit për të gjitha institucionet e burgjeve.
- Të burgosurit po përdorin më shumë se një mënyrë komunikimi për të adresuar ankesat, ndërsa duhet të bëhen funksionale edhe linjat telefonike, të cilat duhet të kategorizohen dhe që kërkojnë gjithashtu një shumëllojshmëri kontrollesh si brenda ashtu edhe jashtë burgjeve;
- DPB ofron kujdes mjekësor parësor për të burgosurit të cilët kurrë nuk kanë kryer një kontroll mjekësor në jetën e tyre, një vlerë e shtuar kjo në komunitetin në përgjithësi, pavarësisht se nuk është kryer në mënyrë të detajuar;
- Vendosja e të burgosurve me probleme të shëndetit mendor në ambiente për përkujdesje të veçantë, për arsye parandalimi dhe trajtimi të shoqëruara me masa mbrojtëse. Në mënyrë të ngjashme janë hartuar protokolle të unifikuara me praktikën ekzistuese.
- Përmirësimi i skedarëve të dixhitalizuar mjekësorë të plotësuar sipas vlerësimit gjithëpërfshirës, i cili adreson gjithashtu çështjet e shëndetit mendor, mbledh dhe menaxhon elektronikisht të dhënat mjekësore, duke përfshirë dokumentacionin elektronik mjekësor (EMRs) dhe menaxhimin farmakologjik;
- Ka një marrëveshje midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe asaj të Drejtësisë për të ndihmuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësorë sekondare në spitalet rajonale, përfshirë edhe

shërbimin e shëndetit mendor; gjithashtu marrëveshje të ngjashme ka me Ministrinë e Arsimit që të përfshijë praktikat dhe programet pasuniversitare të cilat lidhen me ofrimin e kujdesit shëndetësor mendor në burgje.

- Bashkëpunim i ndërsjellë ndërmjet agjencive të ndryshme të sigurisë është vendimtar kur bëhet fjalë për Kundërvënien e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe parandalimin e radikalizimit në burgje;
- Lind nevoja për programe individuale rehabilitimi të miratuara në lidhje me Kundërvënien e Ekstremizmit të Dhunshëm.
- Të këtë mundësi për të vazhduar programe ri-integrimi me periudhë prove apo kushte të parashtruara në bashkëpunim me autoritetet / shërbimet lokale e siguruar për Kundërvënien Ekstremizmit të Dhunshëm.
- Të këtë mundësi për të zhvilluar qasje integrimi në komunitet, ku familjet mund të luajnë një rol të rëndësishëm si pjesë e Kundërvënies ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm.

RREZIQET / KËRCËNIMET:

- Paqëndrueshmëria financiare për të zbatuar projektet dhe modulet përkatëse të nevojshme
- Stabiliteti politik dhe humbja e mundshme e mbështetjes në rast se ka një ndryshim qeverie duke përfshirë këtu edhe ndryshimet e mundshme në zhvillimin ekonomik të vendit, mund të ngadalësojnë vazhdimësinë e reformës në burgje. Për më tepër, ndryshimet e mundshme në qeveri mund të sjellin mungesë vullneti për të organizuar dhe kryer ashtu si duhet inspektimet në burgjeve apo edhe ndërprerje të inspektimeve.
- Ka mungesë personeli në përgjithësi si edhe në mënyrë të veçantë mungesë personeli të specializuar si p.sh psikiatër. Po ashtu, ka mbingarkesë pune si rrjedhojë e mungesës së personelit, ku një punonjës kryen disa detyra pavarësisht se nuk i ka në përgjegjësinë e tij. Kjo shoqërohet me mungesë personeli rezervë, që do të thotë se nëse dikush largohet nga një pozicion i caktuar, memoria institucionale humbet. Në ngjashmëri me këtë, qarkullimi i personelit është shumë i lartë dhe kjo sjell vështirësi në organizimin e trajnimeve.
- Nuk ka testim të posaçëm psikologjik për drejtuesit e burgjeve të cilëve u mungon aftësia dhe fryma e bashkëpunimit ;
- Futja e partneritetit publik-privat në ndërtimin e burgjeve mund të sjellë probleme dhe ndërlikime të paparashikuara;

- Megjithëse për momentin nuk ka mbingarkesë në burgje, kjo mund të ndryshojë në të ardhmen. Gjithsesi mbingarkesë ka në paraburgime çka mund të sjellë probleme të shëndetit mendor;
- Kërkohet më shumë punë për të siguruar etikën mjekësore në burgje, megjithëse ka disa shenja përparimi.
- Masat ndëshkuese kundrejt atyre korrigjuese që rezultojnë nga gjetjet e inspektimeve, si edhe moszbatimi dhe /ose mospranimi i rekomandimeve që burojnë nga inspektimet e burgjeve;
- Pranimi ose mohimi i përfitimeve të caktuara ndaj të burgosurit, bazuar në informacion jo të plotë dhe /ose të pasaktë mund të sjellë veprime korruptive brenda burgjeve.
- Ekziston mundësia që ankesat e parashtruara nga të burgosurit të zbulohen nga të dyshuarit për shkelje, përfshirë këtu rastet e përgjimit të telefonave kur bëhen ankesat, duke pasur parasysh që DPB mund të ketë qasje në ankesat e të burgosurve;
- Lidhur me Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm, qëndron rreziku i krijimit të komuniteteve të izoluara dhe të stigmatizuara, si rezultat i kthimit të mundshëm të individëve të radikalizuar.

OBJEKTIVI 1. FORCIMI I KAPACITETEVE ORGANIZATIVE DHE FUNKSIONALE TË SISTEMIT ZBATIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Masa Nr.1.1 Riorganizimi i shërbimit të ekzekutimeve penale me burgim dhe dënimeve në komunitet		
Pershkrimi i problemit:	Organizimi i ekzekutimit të vendimeve penale në nivel Agjensie, me tre departamente kryesore (Zbatimi i vendimeve penale me burgim, Zbatimi i vendimeve penale në komunitet dhe Departamenti i Sigurisë), si dhe 9 drejtori, të cilat do të jenë të organizuara brenda strukturës së DPB(sic janë). Aktualisht Shërbimi i Provës dhe Shërbimi i Burgjeve, kanë bashkëpunim të parashikuar në marrëveshje. Këshilli i Ministrave ka miratuar një strukturë të re të DPB dhe institucioneve të varësisë, e cila i përgjigjet më së miri misionit. Organizimi i ekzekutimit të vendimeve penale në një agjensi të vetme, do të rris efektivitetin e burimeve njerëzore, sigurinë si dhe kordinimin veçanërisht për ekzekutimin e dënimeve në komunitet.	
Kompetenca:	MD dhe KM	Ekspertë të DPB, SHP, Drejtorisë së Kodifikimit
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 1.1	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr.	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:		
Kusht për:		
Koha:	Kohe zgjatja: 1 vit nga koha e miratimit	Faza : 01.01.2024-31.12.2025

Masa Nr.1.2 Hartimi i një ligji të vetëm mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe me masa në komunitet, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit	
Pershkrimi i problemit:	Sistemi i zbatimit të vendimeve penale, aplikohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës, bazuar në katër ligje: - Ligji Nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” - Ligji Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” - Ligji Nr.78/2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të Provës”

	- Ligji Nr.80/2020 “Për Policinë e Burgjeve” Duke u nisur edhe nga eksperiencia e vendeve të tjera, por edhe nevoja për një menaxhim më të mirë, si në aspektin e kostove dhe nevoja e trajtimit të unifikuar të stafit lidhur me karrierën, trajtimin ekonomik, rotacionin, stautsin, mbështetjen logjistike të agjensisë dhe efektivitetin e shfrytëzimit të aseteve në dispozicion, nevojitet hartimi i një ligji të vetëm.	
Kompetenca:	MD, KM dhe Kuvendi	Ekspertë të DPB, SHP, Drejtorisë së Kodifikimit
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 1.2	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. 1.1	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masës 1.1	
Kusht për:		
Koha:	Kohezgjatja: 1 vit nga koha e miratimit	Faza : Viti 2025

Masa Nr.1.3

Miratimi i strukturës së re organike të Agjensisë së Zbatimit të Vendimeve Penale

Pershkrimi i problemit:	Struktura e DPB dhe Institucioneve të varsisë, është miratuar me Urdhër të Kryeministrit Nr_____, datë/_____/2022 dhe ka në total 4524 punonjës. Struktura e Shërbimit të Provës është miratuar me Urdhër të Kryeministrit Nr_____, datë/_____/2022 dhe ka në total ____ punonjës. Shërbimi i burgjeve ka nën kujdesje 5700 të burgosur Shërbimi i Provës ka nën kujdesje (kontroll, mbikqyrje) 13.000 të dënuar Kërkohe miratimi i një structure të vetme organike Bëhet përshkrim i ri i detyrave dhe funksioneve Organizohet një drejtori e vetme lidhur me shërbimet mbështetëse, financat, Kordinimin dhe informimin, Analiza dhe Vlerësimi I riskut. Qendra e Trajnimeve Krijohen seksione ose sector lidhur me zbatimin e vendimeve penale në komunitet, për mbikqyrjen, kontrollin, hartimin e planit individual të dënimit etj.	
Kompetenca:	MD, KM	Ekspertë të DPB, SHP, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore

Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit te koston nga pika 1.3	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. 1.1 dhe 1.2	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masës 1.1 dhe 1.2	
Kusht për:	Miratimi i krijimit të Agjensisë	
Koha:	Kohezgjatja: 6 muaji nga koha e miratimit	Faza : Gjashtëmujori parë Viti 2026

Masa Nr.1.4

Rikonfigurimi i institucioneve vendore, në përputhje me vlerësimin e sigurisë, objektivave rehabilitues, dhe të trajtimit të grupeve specifike.

Pershkrimi i problemit:	Siç u parashtrua në hyrje të Planit, ekzekutimi i vendimeve penale realizohet në 20 IEVP, nga të cilat 1 institucion për femra, 1 për të mitur dhe një Qendër Shëndetësore për të Burgosurit. Siguria parashikohet në katër nivele: - Siguri e Lartë (tre institucione - Siguri e zakonshme - Siguri e Ulët - Burg i hapur Ky klasifikim është parashikuar prej kohësh në aktet ligjore dhe nuk është zbatuar për arsye infrastrukture. Në këtë masë parashikohet që të ndryshohet urdhëri i Ministrit të Drejtësisë për klasifikimin e IEVP-ve dhe dy IEVP të funksionojnë si burgje të hapura, bazuar në kriteret që parashikon ligji dhe vlerësimin e riskut dhe nevojave. Burgu i Rrogozhinës të funksionojë si burg i sigurisë së ulët dhen në IEVP Shkodër dhe Fier të hapen dy seksione për të burgosur të sigurisë së ulët. Siguria e lartë do të mbetet në Peqin dhe në një institucion tjetër (Korça, ose Fushë Kruja me një kapacitet jo më të lart se 100 vende) Regjimi i Posaçëm do të jetë në IEVP Peqin, me një kapacitet deri në 40 vende. Gratë e dënuara dhe të paraburgosura do të vendosen në Pojskë	
Kompetenca:	MD,	Ekspertë të DPB, Drejtorisë së Policisë
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit te koston nga pika 1.4	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të objektivit 2 ____	
Kusht për:	Rritja e kapaciteteve akomoduese	
Koha:	Kohezgjatja: 1 vit nga koha e miratimit	Faza : Viti 2025

Masa Nr.1.5

Organizimi i sektorit të informacioneve inteligjente

Pershkrimi i problemit:	Në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, janë realizuar dy project, të cilat ndër aktivitetet e rëndësishme kanë patur funksionimin e njësisë së inteligjente për menaxhimin e informacioneve të sigurisë. Megjithëse disa masa janë marrë, si miratimi i një procedure, parashikimi në strukturën organike të IEVP-ve të një analisti risku dhe krijimi në DPB i Drejtorisë së Analizës dhe Vlerësimit të riskut, trajnimi disa herë i grupeve të caktuara të punonjësve të sigurisë, akoma nuk është zbatuar dhe nuk është efiçente njësia perpunimit dhe menaxhimit të informacioneve të sigurisë. Lidhur me këtë masë janë angazhuar edhe ekspertë të DASH dhe do të rishikohet praktika e deritanishme dhe fuqizohet njësia e inteligjencës në DPB	
Kompetenca:	MD,	Ekspertë të DPB, Drejtorisë së Policisë
Burimet:	Financiare: rezultati i vlerësimit të kostos nga pika 1.5	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:		
Koha:	Kohezgjatja: 1 vit nga koha e miratimit	Faza : Viti 2025

Masa Nr.1.6

Riorganizimi i shërbimeve të sigurisë me sistem 12 orë dhe përshtatja e organikës sipas regjimeve të sigurisë.		
Pershkrimi i problemit:	Turnet në shërbimeve të sigurisë janë aplikuar me sistem 8 orë, përveç dy IEVP-ve (Jordan Misja dhe Shkodër), të cilat ka një vit që aplikohet system 12 orësh. Por kjo ka filluar me sforco, pa marrë parasysh parakushte të domosdoshme, siç janë sigurimi i kushteve për pushim dhe i ushqimit për punonjësit në shërbim. Aktualisht është draftuar një udhëzim I përbashkët I dy ministrive (MD dhe MSHMS), për normën ushqimore, por jo akoma nuk është miratuar, pasi kërkohen ndryshime në VKM për pagat dhe trajtimin ekonomik dhe financiar të punonjësve. Nga ana tjetër është e nevojshme të rishikohet gjithë skema e vendshërbimeve dhe të përshkruhen detyrat e pozicioneve të punës, sipas veçorive që kanë dhe jo të përsëriten siç janë më së shumti në procedurën aktuale	
Kompetenca:	MD,	Ekspertë të DPB, Drejtorisë së Policisë
Burimet:	Financiare: rezultati i vlerësimit të kostos nga pika 1.6	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të objektivit 2 ____	
Kusht për:	Rritja e kapaciteteve akomoduese	
Koha:	Kohezgjatja: I vit nga koha e miratimit	Faza : Viti 2024

OBJEKTIVI 2. KRIJMI I NJË AMBJENTI TË SIGURTË DHE PROMOVUES

Masa Nr.2.1

Hapja e IEVP Pojskë për gratë e dënuara dhe të paraburgosura

Pershkrimi i problemit:	Gratë e dënuara dhe të paraburgosura aktualisht janë vendosur në I EVP Ali Demi, një institucion i ndërtuar në formë kampi, për funksionim provizor gjatë viteve 70 të shekullit të kaluar, për shfrytëzimin e të burgosurve për ndërtime të qytetit e Tiranës. Infrastruktura e këtij institucioni nuk përmbush në mënyrë adekuate nevojat për siguri, trajtim human dhe rehabilitim të grave të burgosura. Në afërsi të Pogradecit, në Pojskë është ndërtuar një institucion i ri, me kapacitet prej 120 të burgosur. Nisur nga kushtet e përshtatëshme të infrastrukturës, rekomandimet e A. Popullit, provizorisht gratë e burgosura do të vendosen në Pojskë.	
Kompetenca:	MD,	DPB
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 2.1 (sipas buxhetit të I EVP Ali Demi)	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:		
Koha:	Kohe zgjatja: 3 muaji nga koha e miratimit	Faza : Brenda vitit 2024

Masa Nr.2.2

Investim lidhur me rikonstrutim i pjesshëm dhe rinovimin sistemit të ngrohjes dhe instalimeve elektrike hidraulike, komunikim, e I EVP Fushë Krujë, Peqin dhe Korçë.

Pershkrimi i problemit:	IEVP Fushë Krujë, Peqin dhe Korçë janë në funksionim për një periudhë 15-23 vitesh. I EVP Peqin funksionon totalisht si burg i sigurisë së lartë. I EVP Korçë funksionon si institucion i sigurisë së lartë me një seksion siguri e zakonshme dhe një seksion paraburgim, ndërsa I EVP Fushë Krujë funksionon si institucion i sigurisë së zakonshme dhe një seksion paraburgim. Nga amortizimi i gjatë ka nevojë për nderhyrje të shpejtë për përmirësimin e sistemit të instalimeve elektrike, hidraulike dhe ngrohje.
-------------------------	--

	Ky investim do të bëhet me fondet e siguruara nga UK, bazuar në marrëveshjen e përbashkët të transferimit të të burgosurve.	
Kompetenca:	DPB,	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 2.2	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: një vit nga koha e miratimit	Faza : Viti 2024-2025

Masa Nr.2.3

Ndërtimi i burgut të Qarkut Tiranë, me kapacitet 2000 vende, si paraburgim, burg i sigurisë së zakonshme, siguri e ulët dhe burg i hapur

Pershkrimi i problemit:	Qarku i Tiranës ka në funksion 5 institucione të ekzekutimeve të vendimeve penale me burgim dhe një qendër spitalore për të burgosurit: IEVP Jordan Misja, në funksionim nga viti 1942, kapacitet 480 vende IEVP Mine Peza, në funksionim nga viti 1930, kapacitet 166 vende IEVP Ali Demi, në funksion nga viti 1974, kapacitet 100 vende (gra) IEVP Vaqarr, në funksion nga 1999-2019 (aktualisht i mbyllur) IM Kavajë, në funksion nga viti 2009, kapacitet 40 vende Kushtet e mbajtjes dhe trajtimit të të burgosurve nuk janë të përshtatshme në asnjërin nga këto IEVP, përjashtuar IM Kavajë, i cili ka nevojë vetëm për ndërhyrje të pjesëshme. Thuhet se të gjitha këto IEVP janë rekomanduar për mbyllje (rikonstruktiv total) nga institucionet e pavarura si CPT dhe AP.
-------------------------	--

	Gjithashtu rritja e numrit të të paraburgosurve dhe vendosja e gjykatës së Apelit në Tiranë, e bën të domosdoshme nevojën për rritje të kapaciteteve të burgjeve Për këtë do të planifikohet ngritja e një institucioni të vetëm në Qarkun Tiranë me kapacitet rreth 2000 vende, ku të ketë një seksion burg I hapur dhe një seksion për gratë. - <i>Konkluzione të ekspertëve anglez (Projektit të Binjakëzimit 2016)</i> Jordan Misja Tiranë - Institucioni Jordan Misja ndodhet në qendër të Tiranës, burgu është në gjendje të arsyeshme por jo në standardet e përcaktuara në Rregullat Evropiane të Burgjeve për dritënatyrale dhe ajrosje. Jordan Misja është i përshtatshëm për të mbajtur të burgosur në siguri të lartë dhe siguri standarde. Institucioni ofron shumë pak punë dhe duhet të përdoret për të mbajtur vetëm të paraburgosur. Jordan Misja nuk duhet të përfshihet në sistemin e qendrave të pritjes. Ali Demi – Institucioni Ali Demi duhet të mbyllet dhe duhet të shqyrtohet një rol i ri për Institucionin Vaqarr, që është në afërsi të Tiranës. Ali Demi ka nevojë për investime thelbësore për ta sjellë në standardet e burgjeve evropiane, veçanërisht sistemin e tualeteve, ngrohjen qendrore dhe pajisjen me mjedise pune. Ali Demi është i përshtatshëm për tu përshtatur si Qendër Pritjeje. Mine Peza Tirana – Institucioni Mine Peza është burg me madhësi mesatare (një godinë e vetme) dhe ndodhet në qendër të Tiranës. Ka mjedise të pakta për punë ose aktivitet, qelitë janë me projektim të dobët, me shumë pak dritë natyrale apo ajrosje. Pa bërë përshtatje thelbësore të qelive, Institucioni Mine Peza nuk do të plotësojë kërkesat e përcaktuara në Rregullat Evropiane të Burgjeve. Institucioni Mine Peza është i përshtatshëm për të mbajtur të burgosur në siguri standarde. Mine Peza nuk është i përshtatshëm për të mbajtur qendër pritjeje dhe duhet të mbyllet. Vënia në funksion e institucionit të ri, do të shoqërohet me mbylljen e IEVP Rr. Mine Peza, Rr. Ali Demi dhe godina “A” e IEVP Rr. Jordan Misja	
Kompetenca:	MD,	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 2.3	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):

Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 4 vitet nga koha e miratimit	Faza : Viti 2022 deri në vitin 2030
Masa Nr.2.4		
Rikonstruktimi i IEVP Vaqarr si burg i hapur		
Pershkrimi i problemit:	IEVP Vaqarr ka funksionuar nga 1999-2019 (aktualisht i mbyllur), për shkak të nevojës për rikonstruktim. Ka një kapacitet rreth 160 vende. Është i vendosur në Perendim të Qytetit të Tiranës dhe ka një truall të shfrytëzuar mbi 3 hektar. Ka mundësi për punësim të të burgosurve. Do të rikonstruktohet dhe përdoret për sigurimin dhe trajtimin e të dënuarve nga Gjykata e Kundër Korrupsionit dhe Krimeve të Rënda. - <i>Konkluzione të ekspertëve anglez (Projektit të Binjakëzimit 2016)</i> Vaqarr - Institucioni Vaqarr ndodhet afër Tiranës dhe ka sipërfaqe të mëdha toke dhe disa ndërtesa jashtë godinave kryesore të burgut. Vaqarr është një godinë e vetme akomodimi, në gjendje relativisht të dobët, kërkon investime për të riparuar dhe restauruar godinën kryesore. Institucioni Vaqarr është i përshtatshëm për të mbajtur të burgosur në siguri standarde dhe për të pasur një qendër pritjeje. Duhet të diskutohet për mundësinë e përdorimit të Institucionit Vaqarr si Burgu kryesor për Femra.	
Kompetenca:	DPB,	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vlerësimit të kostos nga pika 2.2	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: një vit nga koha e miratimit	Faza : Viti 2028

Ndërtimi i IEVP Gjirokastrë (Kardhiq) me kapacitet 300 vende

Pershkrimi i problemit:	Qarku i Gjirokastrës ka dy gjykata të shkallës së parë, (në Sarandë dhe në Gjirokastrë). Me miratimin e hartës së re gjyqësore është mbyllur gjykata e Përmetit (për vitin 2021 ka patur vetëm 67 çështje penale dhe ka përfunduar 44) Gjykata e Rr. Gjyqësor Gjirokastrë për vitin 2021 ka patur 836 çështje penale dhe ka përfunduar 341, me 268 të dënuar. Gjykata e Rr. Gjyqësor Sarandë ka patur 327 çështje dhe ka përfunduar 259, me 221 të dënuar. Renta e kriminalitetit për rrethin Gjirokastrë është 268 vepra penale për 100 mijë banorë, dhe 183 krime. Renta e kriminalitetit e rrethit Gjyqësor sarandë është 95 vepra penale për 100 mijë banorë dhe 180 krime për 100 mijë banorë. Duke vlerësuar gjendjen e IEVP Tepelenë që ka një kapacitet 75 vende dhe është ndërtuar nga fillimi I viteve 1960, është e domosdoshme të ndërtohet një institucion i ri për qarkun Gjirokastrë. Në mastër planin e zhvillimit të burgjeve 2004, ishte parashikuar një paraburgim në rajonin Gjirokastrë, fshati Kardhiq. Aktualisht është bërë projekti dhe është marrë trualli. Parashikohet ndërtimi I një burgu dhe seksion paraburgim me kapacitet prej 300 vende. - <i>Konkluzione të ekspertëve anglez (Projektit të Binjakëzimit 2016)</i> Duhet të shqyrtohet ndërtimi i një ndërtese të re burgu në Gjirokastrë ose pranë saj, për të ulur mbipopullimin në institucionet në Jug, dhe për tu mundësuar të burgosurve të vendosen më pranë familjeve të tyre	
Kompetenca:	MD,	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të koston nga pika 2.6	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	

Koha:	Kohezgjatja: 4 vite nga koha e prkurimit	Faza : Viti 2025 deri në 2029
-------	--	-------------------------------

Masa Nr.2.6

Ndërtimi i seksioneve të burgut të hapur në IEVP Korçë, Fier dhe Shkodër me kapacitet deri në 150 vende në total.

Pershkrimi i problemit:	Në ligjin Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” është parashikuar funksionimi I burgut të hapur si një praktikë e mirë e përshtatjes së regjimeve me rriskun dhe nevojat për përgatitjen për lirim të të burgosurve. Institucioni I burgut të hapur nuk ka funksionuar, për arsye të infrastrukturës së munguar. Në këto kushte do të projektohen për të funksionuar si burg I hapur IEVP Ali Demi në Tiranë dhe tre seksione në IEVP Fier, Korçë dhe Shkodër. Seksionet do të projektohen jashtë murit rrethues pa lidhje me regjimin e brendshëm të banimit të të burgosurve.	
Kompetenca:	MD,	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit te koston nga pika 2.7	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 2 vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2025 deri në 2028

Masa Nr.2.7

Mbyllja e burgut të Rrogozhinës dhe ridikompozimi i tij

Pershkrimi i problemit:	IEVP Rrogozhinë është në funksionim nga viti 2001 me një kapacitet rreth 343 shtretër dhe popullim aktual prej 257 të burgosur. Ka funksionuar si burg i sigurisë së zakonshme dhe paraburgim. Aktualisht funksionon vetën si burg i sigurisë së zakonshme, por zakonisht aty vendosen të dënuar me dënime të ulta, ose që e kanë kryer pjesën më të madhe të dënimit. Ka një pozicion të favorshëm në kryqëzim të rrugëve kryesore dhe në një zonë komunitare të mirëpopulluar. Gjendja aktuale e kushteve të trajtimit të këtij institucioni dhe kushteve të sigurisë nuk përmbushin kërkesat më të domosdoshme për funksionim si burg. Shrytëzimi i hapsirës në dispozicion si dhe vendndodhjes, është me interes të përdoret në perspektivë për mbështetjen e programeve rehabilituese dhe të punësimit. - <i>Konkluzione të ekspertëve anglez (Projektit të Binjakëzimit 2016)</i> Rrogozhinë - Institucioni Rrogozhinë është në gjendje të dobët dhe për shumë arsye nuk plotëson standardet evropiane. Këtu përfshihen, përdorim i gjerë i telit me gjemba, pjesa e sipërme e ndërtesës e pasigurt, kushte të dobëta akomodimi. Institucioni ka sipërfaqe të mëdha jashtë godinës kryesore, gjë e cila mundëson mbajtjen e një qendre pritjeje. Megjithatë institucioni është i përshtatshëm për të burgosur në siguri standarde, ai duhet të merret në konsideratë për tu mbyllur	
Kompetenca:	MD,	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vlerësimit të kostos nga pika 2.8	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 2 vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2030

Masa Nr.2.8

Mbyllja e Burgut të Lushnjës dhe ridimensionimi i tij, (ne formen e nje stabilimenti penitenciar bujqesor dhe blegtoral)

Pershkrimi i problemit:	IEVP Lushnjë është në funksionim nga viti 1970 me një kapacitet rreth 189 shtretër dhe popullim aktual prej 184 të burgosur. Ka funksionuar si burg i sigurisë së zakonshme. Aktualisht aty vendosen të dënuar me dënime të ulta, ose që e kanë kryer pjesën më të madhe të dënimit. Ka një pozicion të favorshëm dhe në një zonë komunitare të mirëpopulluar. Gjendja aktuale e kushteve të trajtimit të këtij institucioni dhe kushteve të sigurisë nuk përmbushin kërkesat më të domosdoshme për funksionim si burg. Shfrytëzimi i hapsirës në dispozicion si dhe vendndodhjes, është me interes për rikonstruktion dhe përdorimin e tij si institucioni hapur, në formë të një ferme bujqësore dhe blegtorale për tu shfrytëzuar për nevoja të të burgosurve dhe stafit, gjë që do të sjelle edhe një ulje të kostove të mbajtjes së të burgosurve. - <i>Konkluzione të ekspertëve anglez (Projektit të Binjakëzimit 2016)</i> Lushnje – Institucioni Lushnje ndodhet në një zonë rurale me pamje fantastike të peizazhit rural. Ambientet e brendshme të akomodimit nuk janë në gjendje të mirë dhe ka tualete brenda qelive vetëm pjesërisht. Sektori i veçimit/izolimit është në gjendje shumë të dobët dhe duhet të mbyllet. Pa investime të konsiderueshme Institucioni Lushnje nuk do të mund të përmbushë standardet e kërkuara sipas Rregullave Evropiane të Burgjeve. Institucioni Lushnje mund të përshtatet si burg i hapur dhe, me kapacitet të kufizuar, mund të mbajë një qendër pritjeje.	
Kompetenca:	MD,	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vlerësimit të kostos nga pika 2.9	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 2 vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2030

Masa Nr.2.9

Ndërtim i Qendrës së Trajnimit

Pershkrimi i problemit:	Qendra e Trajnimit te stafit te burgjeve eshte ngritur me VKM Nr.411, date 01.07.1998. Në vitin 2023 QT është strukturuar duke u zgjeruar në 13 punonjës. Në vitet (1999-2006) QT ka qenë vendosur në IEVP Vaqarr dhe përveç ambjenteve mësimore dispononte dhe hoteleri dhe ambjent per ngrenje. Këto ambjente ka vite që janë degraduar dhe trajnimi aktualisht kryhet në IEVP dhe në DPB, ku disponohen disa salla, por jo ambjent akomodimi dhe hoteleri. Kjo sjell shume veshtirësi për faktin se pjesemarresit ne trajnime nuk trajtohen me page, kur jane fillestar. Ngritja e nje qendre trajnimi eshte domosdoshmeri dhe rekomandim i Institucioneve te pavarura për rritjen e cilësisë së trajnimeve.	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit te koston nga pika 2.1	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 3 vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2025 deri në 2028

Masa Nr.2.10

Mbyllja e Burgut të Burrelit dhe rikompozim i tij.(Ngritja e muzeut të burgjeve në burgun Burrel)

Pershkrimi i problemit:	Burgu i Burrelit është në funksion nga viti 1939 dhe gjatë periudhës së regjimit komunist ka shërbyer për sigurimin e të dënuarve politik. Në këtë institucion kanë vuajtur dënimet politike personalitete të shquara të shoqërisë si dy kryeministra, ministra, personalitete të artit shkencës etj. Si institucion I ndërtuar në vitet 30 të shek xx, nuk ka një infrastrukturë të përshtatëshme për misionin e burgjeve aktuale. Kthimi ne muze i ketij institucioni do ishte nje vlere e veçante ne trashegimine kulturore. - Konkluzione të ekspertëve anglez (Projektit të Binjakëzimit 2016) Burrel – Institucioni Burrel është një burg shumë i vjetër dhe pavarësisht se të lë një përshtypje të mirë, gjithsesi me shumë gjasa i ka mbetur edhe pak kohë si një burg funksional. Institucioni Burrel është një burg kompakt me
-------------------------	---

	disa prej qelive në gjendje shumë të mirë dhe të tjera që nuk i plotësojnë standardet Evropiane. Për shkak të projektit të ndërtimit dhe vendndodhjes, Institucioni Burrel është i përshtatshëm për të mbajtur të dënuar siguri e lartë dhe siguri standarde. Gjithashtu Institucioni Burrel mund të luaj një rol në sistemin e propozuar të qendrave të pritjes.	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 2.1	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 2 vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2029 deri në 2030

Masa Nr.2.11

Mbyllja e burgut Tepelenë, Rikompozim

Pershkrimi i problemit:	Burgu i Tepelenës është në funksion nga viti 1960 dhe gjatë periudhës së regjimit komunist ka shërbyer për sigurimin e të dënuarve politik. Në qytetin e Tepelenës në vitet 1949-1954 ka qenë ngritur një nga kampet më famëkeqe ku janë internuar mira familje bashkë me fëmijët e tyre, vetëm se konsideroheshin kundërshtarë të regjimit komunist. Kushtet e këtij burgu nuk janë të përshtatshme dhe me ndertimin e burgut të Gjirokastrës, bëhet I panevojshëm si burg. - <i>Konkluzione të ekspertëve anglez (Projektit të Binjakëzimit 2016)</i> Tepelenë – Institucioni Tepelenë ndodhet në një luginë të thellë lumi dhe ka rrotull kodra të pjerrëta. Është një burg i vogël që mban të burgosur siguri e lartë dhe siguri standarde. Burgu ofron mundësi të kufizuara për punë dhe hapësirat e ajrimit janë të rrethuara me mure të lartë. E ardhmja në planin afat-gjatë e këtij burgu duhet diskutuar nëse do të plotëson standardet evropiane të burgjeve. Burgu është në gjendje të akomodojë të burgosur në siguri standarde dhe të mbajë një qendër pritjeje. Përmasat e vogla, kushtet e qelive dhe vendndodhja e
-------------------------	--

	izoluar e bëjnë të papërshtatshëm për të mbajtur të burgosur me risk të lartë.	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të koston nga pika 2.1	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr.2.6 dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohe zgjatja: 2 vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti deri në fund të vitit 2025

Masa Nr.2.12

Përmirësimi i sistemit të mbylljes së dyerve

Pershkrimi i problemit:	Sistemi i kyçjes së dyerve/portave Sistemi aktual i kyçjes dhe përdorimi i kyçeve me çelësa të veçantë në dyert/portat e qelive dhe ato të dhomave të veçimit përbën rrezik serioz për jetët e të burgosurve dhe stafit në rast zjarri. Do të ishte i vështirë evakuimi i personave nga qeli të tilla si ato në Tepelenë, Mine Peza e tje në rast të rënjes së zjarrit. Një ngjarje me rënje zjarri në IEVP Lezhë, më 2015 dhe një i burgosur ka humbur jetën. Duhet të parashikohet zëvendësimi i çelësve të qelive me një çelës të vetëm. Sistemi i hyrje daljeve, do të ishte më funksional, nëse dyert kryesore do të hapeshin në mënyrë automatike pa ndihmën e punonjësit të sigurisë.	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të koston nga pika 2.16	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Ka lidhje me:	Masa Nr.2.6 dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 2 vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2025 deri në 2028

Masa Nr.2.15

Mbyllja e godinës “A” të IEVP Rr. “Jordan Misja” Rikompozim i saj.

Pershkrimi i problemit:	IEVP Jordan Misja është e përbërë nga dy ndërtesa (A dhe B) për të burgosur dhe një ndërtesë për administratën. Ndërtesa A është me kapacitet mbi 300 të paraburgosur dhe është në përdorim nga viti 1943. Nisur nga pozicionimi i këti institucioni në afërsi të Gjykatës së Krimeve të rënda dhe SPAK, janë bërë rikonstruktime të kalimeve nga burgu drejt përdrejt në sallën e gjykimit, pa shoqërim më automjet transporti gjë që rrit sigurinë gjatë seancave gjyqësore, dhe shoqërimeve, por ul edhe kostot e transportit dhe kursen kohën. Por siç dihet dhe është konstatuar edhe nga partnerë të rëndësishëm si AP, CPT etj, kushtet e godinës A, janë të papërshtatshme dhe çënojnë të drejtat themelore të shtetasve për një trajtim human. Në rekomandimet e CPT, nga vizita e periudhës 4-15 maj në burgjet e Shqipërisë, dërguar me shkresë Nr.9570, datë 27.06.2023, është lënë ky rekomandim: <i>Blloku A i banimit në burgun 313 duhet t'i nënshtrohet rinovimit pa vonesa të mëtejshme me qëllim sjelljen e kushteve të përgjithshme të jetesës në një nivel të pranueshëm. Objektivat afatmesëm duhet të jetë nxjerrja jashtë përdorimi i kësaj godine.</i>	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 2.15	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):

Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 2 vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2030

Masa Nr.2.16

Ndërtimi i paraburgimit të Qarkut Kukës

Pershkrimi i problemit: Në hartën e re gjyqësore është parashikuar të funksionojë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës. Në këto kushte ishte parashikuar edhe në Master Planin e vitit 2004, për të ndërtuar një paraburgim me kapacitet 150 vende në qytetin e Kukësit (Gostil).
Me qëllim aksesin në drejtësi të subjekteve dhe rritjen e efektivitetit në sigurimin dhe trajtimin e shtetasve me masë sigurie me burgim do të ndërtohet paraburgimi i Kukësit

Kompetenca:	MD, DPB AKSH	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 2.16	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
----------------------	------------------------	-------------------

Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
------------	---------------------	--

Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
------------	-----------------------	--

Koha:	Kohezgjatja: i vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2027-2030
-------	---	-----------------------

Masa Nr.2.17

Pajisja e IEVP-ve me salla video konferenc, për gjykime online

Pershkrimi i problemit:	Në vitin 2023 në sistemin gjyqësor ka filluar zbatimin harta e re gjyqësore, e cila ka sjellë mbylljen e disa gjykatave të shkallës së parë dhe krijimin e një gjykate të vetme apeli, me seli në Tiranë. Në këto kushte është shtuar kostoja për shoqërimin e të burgosurve, nga Shkodra në Tiranë, nga Korça në Tiranë, nga Vlora në Tiranë, nga Gjirokastra në Tiranë dhe nga Durrësi në Tiranë. Për lehtësimin e transportit, uljen e kostove dhe rritjen e sigurisë, në disa IEVP nevojitet të krijohen ambiente me mjete komunikimi per video konferenca, me qëllim që të burgosurit të marrin pjesë në seancat gjyqësore, e njëjta siç është vepruar gjatë pandemisë	
Kompetenca:	MD, DPB AKSH	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit te koston nga pika 2.16	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: i vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2025-2026
Masa Nr.2.18 Ndërtimi i sistemit voltaik për prodhimin e energjisë së gjelbërt në IEVP Korçë, Reç dhe Fier		
Pershkrimi i problemit:	Ulja e kostove të shpenzimeve është një prej prioriteteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Një nga mundësitë për uljen e kostove të shpenzimeve është prodhimi I energjisë së gjelbërt. Vetëm në vitin 2023 DPB ka shpenzuar 304.063.663 lek për energji, gjë që përbën një barrë të madhe të shpenzimeve. Për prodhimin e energjisë elektrike të nevojshme për prodhimin e 10 milion KË energji, që shpenzohet sot nga 8 IEVP të vendit (Korçë 0.615 Milion KË, Shkodër 1.8 miolion KË, Peqin 1.54 Milion KW, Fier 2.9 Milion KW, Fushë-Krujë 0.7 Milion KW etj) duhet të ndërtohen tre qendra fotovoltaike për prodhimin e energjisë së gjelbërt në Korçë, Fier dhe Shkodër me një kosto 9.75 milion Euro. Nga ky investim brenda dy viteve kthehen gjithë investimi i kryer. Në këtë mënyrë krijohet mundësia e investimeve për përmirësim të kushteve të trajtimit, rehabilitimit dhe punësimit, duke sjellë përsëri ulje të kostove të sistemit të burgjeve.	

Kompetenca:	MD, DPB AKSH	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	FinanciareDonatorë	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: i vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2026-2027

OBJEKTIVI NR.3: NGRITJA E NJË EKIPI TË QËNDRUESHËM, ME INTEGRITET, TË MOTIVUAR DHE PROFESIONAL

Masa Nr.3.1 Parashikimi i ndryshimeve në strukturën organike, në nivel agjensie, struktura e re përshkrimi i detyrave dhe miratimi		
Përshkrimi i problemit:	Miratimi i krijimit të Agjensisë së Zbatimit të Vendimeve Penale, siç parashikohet në objektivin 1.1, sjell nevojë të domosdoshme miratimin e një strukture të re organike të stafit.Për këtë do të ngrihet grup pune për të vlerësuar nevojat për shtesa, përshkrimin e detyrave për çdo pozicion.	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vlerësimit të kostos nga pika 3.1	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Ka lidhje me:	Masa Nr.1.1 dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 1 vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2024

Masa Nr.3.2

Miratimi i dokumentit të zhvillimit të karrierës, për çdo funksion

Pershkrimi i problemit:	Për të krijuar një organizatë të qëndrueshme, është e domosdoshme promovimi dhe krijimi i hapsirave për zhvillim karriere të punonjësve. Ligji i Policisë së Burgjeve, parashikon zhvillimin e karrierës. Nga praktika e deritanishme ka patur prurje të reja në të gjitha nivelet e shërbimeve, duke penguar zhvillimin e karrierës. Të dhënat lidhur me lirimet dhe largimet nga puna tregon se nuk ka shumë interes për të punuar në system të burgjeve. Një nga këta faktorë, është dhe mungesa e mundësisë për zhvillim karriere.	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 3.2	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 1 vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2024

Masa Nr.3.3

Miratimi i dokumentit të mbështetjes psikologjike të stafit të sigurisë

Pershkrimi i problemit:	Stafi i burgjeve, përjeton një stress dhe frustrim, për shkak të punës në ambiente të mbyllura dhe në prani të të burgosurve, i cili ndikon drejt për drejt në mirqenjen dhe shëndetin e tyre. Në vitet e fundit janë marrë disa masa për mbështetjen dhe trajnimin e stafit, si zgjidhja e problemit të transportit dhe po vleresohet rishikimi i vendshërbimeve. Ky document eshte rekomanduar edhe nga KLSH.	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 3.3	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 1 vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2024

Masa Nr.3.4

Garantimi i transportit në IEVP-të larg qendrave të banimit dhe ushqimit për punonjësit e sistemit të burgjeve, me ose pa uniformë

Pershkrimi i problemit:	Me mbështetjen e buxhetit të shtetit dhe të Mbreterise se Bashkuar është fuqizuar flota e automjeteve të DPB për transport të të burgosurve dhe stafit. Te gjithë IEVP-te do te kene automjet ne dispozicopn per mbeshtetjen e punonjesve qe jane larg qendres se punes. Nje akt nenligjor eshte ne proces, qe parashikon nje vakt falas per te gjithë punonjesit e sigurise që janë në shërbim 8-12 ore. Nepermjet kesaj mase do te rishikohen edhe turnet e shërbimit.	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 3.4	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 1 vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2024

Masa Nr.3.5

Rishikimi i Kodit të Etikës dhe miratimi i një dokumenti të vetëm për të gjithë stafin e burgjeve

Pershkrimi i problemit:	Siç dihet KE ka miratuar rekomandimin për kodin e etikës të punonjësve të burgjeve (Rek 2012 (5). Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka në fuqi Kodin e sjelljes të punonjësve të burgjeve dhe paraburgimit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr.3052/1 viti 2005. Gjithashtu është miratuar edhe kodi i sjelljes së punonjësve të policisë së burgjeve në vitin 2021, miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Në zbatim të rekomandimit 2012 (5), duhet të miratohet një kod i vetëm, pasi përgjegjësitë dhe fusha e veprimit janë të njëjta për të gjithë punonjësit e burgjeve.	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vlerësimit të kostos nga pika 3.5	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 1 vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2024

Masa Nr.3.6

Kreditimi i trajnimeve, sipas niveleve të përgjegjësisë, karrierës dhe nevojave

Pershkrimi i problemit:	Qendra e Trajnimit ofron trajnime të shumta për stafin e burgjeve, të cilat ndihmojnë në rritjen e standarteve dhe cilësinë e shërbimeve. Aktualisht trajnimet nuk janë të akredituara, ndonëse kulikulat janë të hartuar me mbështetjen e ekspertëve të KE dhe partnerëve të tjerë. Qendra e Trajnimit ka bashkëpunim edhe me Akademinë e Sigurisë. Forcimi I mëtejshëm I trajnimeve, kërkon që trajnimet të jenë të kredituara dhe të përcaktohet për çdo punonjës një sasi e caktuar kreditesh për çdo vit. Kjo do të nxis më shumë interesin për trajnimet	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 3.6	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 1 vite nga koha e prokurimit	Faza : Viti 2025

Masa Nr.3.7

Ngritja e kursit të nivelit të mesëm dhe të lartë të menaxhimit, në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë dhe Institucionet Universitare

Pershkrimi i problemit:	Aktualisht Qendra e Trajnimit ofron trajnim baze si dhe trajnime të tjera, trajnim në detyrë, për grupe specifike etj. Eshtë e domosdoshme që të ngrihet kursi i trajnimit për liderшипin, ku të përfshihen të gjithë drejtuesit para emerimit dhe gjatë karrierës, si trajnim në detyrë. Ky trajnim mund të realizohet në bashkëpunim me Universitetet ose Akademinë e Sigurisë. (Një kurs i tillë është ngritur për drejtorët e shkollave)	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 3.7	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 1 vite nga koha e miratimit	Faza : Viti 2025

Masa Nr.3.8

Miratimi i kritereve të vlerësimit të performancës të punonjësve, Drejtorive dhe IEVP-ve

Pershkrimi i problemit:	Deri tani nuk ka një format të unifikuar, të qëndrueshëm dhe të vlerësuar lidhur me vlerësimin e performancës, përveç formatit të DAP për nëpunësit civil. Krahas vlerësimit të performancës së punonjësve, kërkohet edhe kriteret e vlerësimit të performancës së IEVP-ve dhe drejtorive Brenda DPB	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vlerësimit të kostos nga pika 3.8	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 1 vite nga koha e miratimit	Faza : Viti 2024

Masa Nr.3.9

Fuqizimi i bibliotekës së Qendrës së Trajnimit (online dhe fizike)

Pershkrimi i problemit:	Rritja e cilësisë dhe efektivitetit të trajnimeve kërkon rishikim të vazhdueshëm të kulikulave dhe pasurim të moduleve. Një burim i rëndësishëm është përkthimi dhe përshtatja e të gjitha manualeve të hartuara nga UNDC. Krahas manualeve të trajnimit është e nevojshme rishikimi në mënyrë periodike i procedurave të sigurisë dhe menaxhimit	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vlerësimit të kostos nga pika 3.9	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 1 vite nga koha e miratimit	Faza : Viti 2024

OBJEKTIVI 4: FORCIMI I PROCESIT TË REHABILITIMIT DHE RI-INTEGRIMIT TË TË BURGOSURVE

Masa Nr.4.1 Aplikimi i procedurave të klasifikimit të brendshëm të burgosurve, bazuar në vlerësimin e riskut dhe nevojave.	
Pershkrimi i problemit:	Vlerësimi i riskut dhe nevojave mbetet baza e një ndërtimit të planeve individuale me objektiva dhe synime të qarta lidhur me rehabilitimin e të burgosurve. Aktualisht sistemi i vlerësimit të riskut dhe nevojave bazohet më shumë në factor static dhe është shumë i ngurtësuar. Sistemi i burgjeve ka në përgjegjësi trajtimin dhe sigurimin e 476 të burgosur të sigurisë së lartë dhe 1697 të sigurisë së zakonshme. Përveçqë duhet të aplikohet sistemi i vlerësimit në 4 kategori (e lartë, zakonshme, e ulët dhe burg i hapur), është e nevojshme edhe klasifikimi i brendshëm në dy deri në tre nivele, Brenda institucionit, me qëllim përshtatjen e regjimeve dhe të shërbimeve e

	agjendave për rehabilitim. Ky aktivitet është duke u mbështetur nga KE në kuadër të projektit Mbështetje Horizontale.	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 4.1	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të ____	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 1 vite nga koha e miratimit	Faza : Viti 2024

Masa Nr.4.2

Ndryshimi progresiv i nivelit të sigurisë

Pershkrimi i problemit:	Aktualisht vetëm një numër shumë i kufizuar i të burgosurve mund të ndryshojnë nivelin e sigurisë nga siguri e lartë në siguri të zakonshme, process që nis me kërkesën e të dënuarit ose avokatit të tij dhe e vendos gjykata. Shumica e të dënuarve që dënohen me burg të sigurisë së lartë, e përfundojnë dënimin po në këtë nivel sigurie. Për ta ndryshuar këtë do të ishte e nevojshme që stafi i burgjeve të marrë më shumë rol në ndryshimin e sigurisë duke patur parasysh edhe koston e lartë dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, por mbi të gjitha të drejtat e të burgosurve dhe potencialin e gjithsecilit për ndryshim. Ky aktivitet është duke u mbështetur nga KE në kuadër të projektit Mbështetje Horizontale.	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vleresimit të kostos nga pika 4.2	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):

Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 1 vite nga koha e miratimit	Faza : Viti 2024

Masa Nr.4.3

Menaxhimi i integruar i planit të dënimit, në bashkërendim me Shërbimin e Provës

Pershkrimi i problemit:	Analizë e nevojave aktuale të të burgosurve për planifikimin para lirimit dhe mbështetjen pas-lirimit në nivel lokal dhe kombëtar Programe të individualizuara për përgatitjen e lirimit të hartuara për të gjithë të burgosurit sipas nevojave të tyre Promovimi i përdorimit të regjimeve progresive (duke përfshirë regjimet e hapura dhe gjysmë të hapura, lejet për të vizituar familjen dhe skemat e lirimit) për të mbështetur rehabilitimin dhe përgatitjen e të burgosurve për lirim	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vlerësimit të kostos nga pika 4.3	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 2 vite nga koha e miratimit	Faza : Viti 2024 -2025

Masa Nr.4.4

Programet e punësimit brenda dhe jashtë institucioneve, në partneritet me operator ekonomik dhe punësim individual për kategorinë e të dënuarve në burgje të hapura.

Pershkrimi i problemit:	Miratimi i VKM për procedurat e punësimit dhe të shpërblimit të dënuarve është një mbështetje e plotë nga ana ligjore e procesit. Deri tani janë punësuar me kontratë rreth 500 të dënuar, nga të cilët 56 janë të punësuar nga operatori ekonomik që është i kontraktuar për furnizimet e të burgosurve. Thuajse nuk është realizuar asnjë nismë për punësimin e të burgosurve nëpërmjet kompanive, apo vetë punësim, as jashtë dhe as brenda institucionit Vendosja e bashkëpunimit dhe partneritetit midis burgjeve individuale, kompanive private dhe OJQ-ve kombëtare e ndërkombëtare për ofrimin e programeve rehabilituese (dhe kompanive private për ofrimin e punës në burg)	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vlerësimit të kostos nga pika 4.3	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohe zgjatja: 2 vite nga koha e miratimit	Faza : Viti 2024 -2025

Masa Nr.4.5

Fuqizimi i kurseve profesionale dhe arsimit në sistemin e burgjeve

Pershkrimi i problemit:	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka bërë përpjekje të mjaftueshme në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e ekonomisë për mundësinë e arsimit të të burgosurve dhe aftësimin e tyre profesional. Megjithatë numri I të burgosurve përfitues deri tani është I ulët. Arsimimi nuk është një aktivitet sistematik, nuk ka qëndrueshmëri, nuk ka interes të mjaftueshëm. Po kështu edhe gjendja e formimit profesional. Një udhëzim është duke u miratuar, por nuk mjafton pa mbështetje nga ana infrastrukturore por edhe gatishmërinë e institucioneve relevante.	
Kompetenca:	MD, DPB	Drejtoria e B.Njerëzore, Shërbimeve dhe Investimeve
Burimet:	Financiare: rezultati i vlerësimit të kostos nga pika 4.5	Personeli: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Ka lidhje me:	Masa Nr. ____ dhe ____	Arsyeja (Shenim):
Varet nga:	Zbatimi i Masave të	
Kusht për:	Ecuria e marrëveshjes	
Koha:	Kohezgjatja: 2 vite nga koha e miratimit	Faza : Viti 2024 -2025